

Raporti monitorues i keqinformimit për muajin mars

2023

prill 2023

Action for
Democratic Society
hibrid.info



Raporti monitorues i keqinformimit për muajin mars

Publikues: ADS/hibrid.info

Prishtinë, prill 2023

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga ADS/hibrid.info. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta dhe me Ligjin Nr. 05/L-047 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të bartet, në çfarëdo forme apo me çfarëdo mjeti, qoftë mekanik, me fotokopje, incizim apo në mënyra të tjera, pa lejen paraprake me shkrim të botuesit

Ky raport është publikuar nga Action for Democratic Society (ADS) në kuadër të projektit “Promovimi i gazetarisë objektive dhe lufta kundër dezinformimit”, që mbështetet nga National Endowment for Democracy (NED).

Përmbajtja e dokumentit është përgjegjësi e ADS-së dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se pasqyron qëndrimin e NED-it.

Projekti financohet nga:



Projekti realizohet nga:



Përmbajtja

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese

Llojet e fushave tematike

Llojet e publikuesve

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Llojet e mediave sociale

Figurat dhe Institucionet më të përfolura

01. 02. 03. 04. 05. 06. 07.

Hyrje

Ky raport përmbledhës dhe përshkruës, i pari i këtij lloji në Kosovë deri më tash, pasqyron gjendjen e informimit (keqinformimit) gjatë muajit mars 2023, bazuar në të dhënat e siguruara nga platforma për kontroll të fakteve – hibrid.info. Format i këtij raporti është monitorues dhe paraqet gjendjen për një periudhë njëmuajore, ndërsa ky është raporti i nëntë mujor i publikuar deri më tash.

Ky raport është i ideuar nga platforma për kontroll të fakteve hibrid.info, pjesë e OJQ-së kosovare “Action for Democratic Society” (ADS) dhe mbështetet nga fondacioni amerikan “National Endowment for Democracy” (NED) në kuadër të projektit “Promovimi i Gazetarisë Objektive dhe Luftimit të Dezinformatës”.

Në kuadër të raportit jepet një pasqyrë për formën e informimit mediatik me ngjarjet për dhe rreth Kosovës. Në vazhden e këtij raporti paraqiten disa figura (grafika) të dala nga baza e të dhënave të hibrid.info e ndarë përmes disa kategorive të vlerësimit që janë pjesë e metodologjisë për kontroll të fakteve të kësaj platforme.

Raporti trajton 8 kategori krahasuese të të dhënave, duke synuar të jep një sqarim më objektiv të gjendjes së informimit dhe për të shpjeguar tendencat e keqinformimit për këtë periudhë monitoruese.

Kategoritë monitoruese janë:


- Vlerësimet e artikujve keqinformues
- Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese
- Fushat mbi të cilat janë krijuar dhe shpërndarë artikujt keqinformues
- Institucionet dhe personat e përfolur në artikujt keqinformues
- Llojet e mediave që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Kategorizimi i mediave në gjuhën shqipe dhe serbe që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e mediave sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese
- Llojet e publikuesve në mediat sociale që kanë krijuar e shpërndarë përmbajtje keqinformuese

Përmbajtja e trajtuar nga hulumtuesit e hibrid.info e që ka shërbyer për ndërtimin e këtij raporti është kryesisht ajo e publikuar në gjuhën shqipe dhe serbe.

Kategoritë vlerësuese të keqinformimit

KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas kategorive vlerësuese



Sipas matjeve të muajit mars 2023, numri më i madh i publikimeve keqinformuese kanë marrë vlerësimin “Clickbait” me 27%, e cila pasohet nga kategoria “Dezinformatë” me 26%. Në vendin e tretë janë vlerësuar keqinformimet në kategorinë “Mashtrim” me 14%. Edhe në muajin paraprak monitorues (shkurt 2023), kategoritë clickbait dhe dezinformatë ishin në vendin e parë dhe të dytë përkatësisht, megjithatë, gjatë këtij muaji, përqindja mes tyre është shumë e ngushtë me vetëm 1% dallim.



27% e artikujve keqinformues kanë marrë vlerësimin “Clickbait”.

Analizë e llojeve të vlerësimeve

1.1

01. Clickbait

Artikujt me përmbajtje keqinformuese në këtë kategori i përkasin më së shumti fushave të kronikës së zezë dhe çështjeve sociale. Në kuadër të tyre trajtohen tema të ndryshme, si vrasje, zhdukje, protesta, shëndeti i fëmijëve, punësimi në Gjermani, tregu i punës etj. Vlerësime clickbait kanë marrë edhe disa publikime me tema politike, të sportit dhe motit, por në përqindje më të vogël. Të gjitha publikimet e kësaj kategorie janë në gjuhën shqipe, të publikuara kryesisht nga mediat reale dhe, në numër dukshëm më të vogël, nga mediat sociale dhe portalet e dyshimta.

03. Mashtrim

Edhe në këtë kategori artikujt keqinformues për çështje sociale kanë mbizotëruar mbi temat tjera. Në këto tema trajtohet dhënia e pasurisë, donacione të veturave dhe një artikull mashtrues për veshjen e Papa Françeskut përmes metodave të inteligjencës artificiale. Edhe një artikull keqinformues për “Big Brother Vip Albania” i vlerësuar si mashtrim u publikua gjatë këtij muaji. Të gjitha publikimet në këtë kategori vlerësuese u krijuan dhe shpërndan nga mediat sociale, kryesisht në gjuhën shqipe, me përjashtim të një artikulli në gjuhën angleze që u shpërnda në median sociale Reddit.

05. Lajm i rremë

Edhe në këtë kategori publikimet kryesore keqinformuese kanë trajtuar çështje politike dhe të sigurisë. Në këto publikime shpërndahen lajme të rreme për kryeministrin Kurti, për largim të serbëve nga Mitrovica, si dhe pretendime të rreme nga misioni rus i OSBE-së me rastin e rikujtimit të ditës së fushatës ajrore të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë. Publikimet keqinformuese në kategorinë e lajmeve të rreme janë publikuar e shpërndarë në mediat sociale, kryesisht në gjuhën shqipe dhe një artikull në gjuhën angleze por nga një kanal zyrtar rus.

02. Dezinformatë

Publikimet keqinformuese për çështje sociale kanë marrë më së shumti vlerësime si dezinformata, në të cilat trajtohet punësimi në Gjermani dhe Zvicër, diaspora në Zvicër dhe transporti rrugor. Ajo pasohet nga keqinformimet për zhvillimet që ndërldihen me programin televiziv “Big Brother Vip Albania” dhe publikimet dezinformuese për çështje të sigurisë lidhur me veriun e Kosovës. Vlen të përmendet se në këtë kategori, gjatë këtij muaji, nuk kishte publikime keqinformuese në fushën politike. Shumica e artikujve të kësaj kategorie vlerësuese janë publikuar nga mediat sociale dhe portalet e dyshimta në gjuhën shqipe, përderisa ngjashëm si muajve paraprak, artikujt për veriun e Kosovës janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe.

04. Teori konspirative

Publikimet keqinformuese në fushën politike dhe të sigurisë kanë dominuar në kategorinë e teorisë konspirative gjatë këtij muaji monitorues. Përmes këtyre artikujve, të publikuara nga mediat në gjuhën serbe, pretendohet pa fakte se komuniteti serb në Kosovë po ndjehet i frikësuar dhe nën presion nga institucionet e Kosovës, për raportet mes Kosovës dhe Serbisë, zhvillimet në komunat me shumicë serbe në Kosovë, procesin gjyqësor ndaj Azem Kurtajt etj. Me përjashtim të një artikulli keqinformues në gjuhën shqipe, i publikuar në mediat sociale, të gjithë artikujt tjerë në këtë kategori janë publikuar nga mediat reale në gjuhën serbe.

06. Gabim


Artikujt me përmbajtje keqinformuese të vlerësuar si gabim kanë trajtuar tema të ndryshme të kronikës së zeze, çështjeve sociale dhe sportit, të publikuara nga mediat reale në gjuhën shqipe.

Artikuj të tjerë me përmbajtje keqinformuese janë vlerësuar në kategoritë “Manipulim i fakteve” dhe “Përmbajtje e paverifikuar” që trajtojnë tema politike e të sigurisë, ekonomisë dhe çështjeve sociale.

Temat e përdorura për krijimin dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese


KATEGORITË KRYESORE

Këtu janë renditur kategoritë kryesore sipas temave



Gjatë muajit mars 2023, temat mbi të cilat më së shumti janë krijuar dhe shpërndarë publikime keqinformuese nga media të ndryshme janë ato për çështjet sociale. Tema kryesore në fushën sociale janë disa artikuj të raportuar si mashtrim, ku përmes fotografive false krijohen rrëfime të trilluara se persona të ndryshëm po dhurojnë pasuri. Edhe programi televiziv “Big Brother Vip Albania” dhe disa artikuj si dhe tema rreth punësimit në Gjermani, janë përdorur mjaft për t’u krijuar përmbajtje keqinformuese gjatë këtij muaji.

Temat politike, edhe gjatë këtij muaji, janë në vendin e dytë në kontekst të zhvillimeve politike e të sigurisë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, me theks të veçantë për disa pretendime pa fakte të mediave në gjuhën serbe për presion e sulme të organizuara nga Kosova kundër komunitetit serb, keqinformime për kryeministrin Kurti etj.



39% e temave kryesore kanë qenë për dhënie të pasurisë, programin “Big Brother Albania”, kryeministrin Kurti, punësimin në Gjermani, vrasje, pretendime pa fakte për presion ndaj komunitetit serb në Kosovë etj.

Analizë e kontrolleve të fakteve sipas temave

2.1

Matjet nga monitorimi mujor tregojnë se mediat më së shumti i kanë kushtuar rëndësi publikimeve keqinformuese për çështjet sociale në krahasim me temat tjera. Në kontekst të zhvillimeve të caktuara në kuadër të kësaj teme, shihet se keqinformimet për dhënie të pasurisë, programi “Big Brother Vip Albania” dhe punësimi në Gjermani janë temat kryesore që kanë nxitur kureshtjen më të madhe të publikueseve të përmbajtjeve keqinformuese, qofshin ata menaxhues të faqeve/grupeve/profileve në media sociale apo të portaleve të dyshimta.

Pavarësisht se këtë muaj (mars 2023) ka pasur zhvillime politike në ndërlidhje me dialogun Kosovë-Serbi dhe ishte arritur në Ohër marrëveshje për zbatimin e aneksit të marrëveshjes drejt normalizimit të marrëdhënieve mes të dyja vendeve, megjithatë çështjet politike kanë mbetur nën hije të temave sociale sa i përket keqinformimit. Rrjedhimisht, disa prej artikujve kryesorë në këtë drejtim janë në raport me kryeministrin Kurti dhe disa pretendime të pabaza të ngritura nga mediat serbe sa i përket komunitetit serb në Kosovë.

Në vijim analizohen, në formë të përmbledhur, katër temat kryesore të trajtuara nga mediat e ndryshme, sipas matjeve të “hibrid.info” përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve.

01. Dhënie të pasurisë

Për këtë temë janë shpërndarë publikime keqinformuese që kanë marrë vlerësime në kategorinë e mashtrimit, të cilat janë publikuar në Facebook, në gjuhën shqipe. Shumica e këtyre artikujve përmbajnë fotografi false të disa grave me pretendimin se ato po dhurojnë dhe shpërndajnë pasuri në Kosovë e vende të tjera.

03. Punësimi në Gjermani

Media të dyshimta dhe profile në mediat sociale kanë publikuar disa artikuj keqinformues në kategoritë clickbait dhe dezinformatë lidhur me punësimin në Gjermani. Në këto publikime pretendohet se shteti gjerman po ofron shuma të majme parash për punonjësit e ri, ri-publikohen lajme të vjetra për vizat e punës në Gjermani dhe artikuj me titull të sajuar për kushtet e punës në këtë shtet. Këto keqinformime me tematikë sociale janë publikuar në gjuhën shqipe.

02. BBVA

Artikujt keqinformues për programin “Big Brother Vip Albania” janë publikuar në mediat sociale dhe portalet e dyshimta, në gjuhën shqipe, që kanë në fokus njërin nga personazhet e këtij programi i cili gëzon shikueshmëri të madhe jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Këto publikime janë vlerësuar si dezinformatë dhe mashtrim për shkak se përmbajnë pretendime të pasakta apo përmbajtje gjysmë të vërtetë, si dhe mashtrime.

04. Kryeministri Kurti


Artikujt keqinformues të krijuar dhe shpërndarë për kryeministrin Albin Kurti i përkasin fushës politike dhe të sigurisë, të cilat kryesisht janë publikuar në gjuhën shqipe, në mediat sociale dhe më pak në mediat reale. Përmes këtyre artikujve, të vlerësuar si lajme të rreme dhe clickbait, pretendohet pa fakte se grupi rus “Wagner” ka ofruar 15 milionë dollarë për vrasjen e Kurtit, si dhe disa keqinformime që në tituj e ilustrime aludojnë në kryeministrin Kurti, por në përmbajtje trajtojnë krejtësisht personalitete tjera publike/politike.

Llojet e fushave

Numri më i madh i publikimeve keqinformuese, gjatë muajit mars 2023, është krijuar dhe shpërndarë nga media të ndryshme në fushën sociale prej 36%, pasuar nga temat në fushën politike me 16%, kronika e zezë 14% dhe çështjet e sigurisë 13%. Temat sociale në vazhdimësi kanë mbizotëruar në periudhat e ndryshme monitoruese dhe kjo dëshmohet prej matjeve në baza mujore të hybrid.info përmes metodologjisë së kontrollit të fakteve. Interesimi i mediave për të krijuar dhe shpërndarë përmbajtje keqinformuese në fushën sociale mund të jetë për shkak të kureshtjes së lexuesve për këtë temë, marrë parasysh është situatën aktuale socio-ekonomike të rritjes së çmimeve dhe efektet e prodhuara nga kriza ekonomike, që nga viti 2022, kur filloi pushtimi ushtarak rus në Ukrainë.

FUSHAT KRYESORE

Këtu janë renditur 6-të fushat kryesore



Artikujt keqinformues në fushën sociale janë publikuar më së shumti në mediat sociale dhe në numër shumë më të vogël në mediat reale dhe portalet e dyshimta. Pothuajse të gjitha janë krijuar në gjuhën shqipe dhe janë vlerësuar kryesisht në kategoritë e mashtrimit, dezinformatës dhe clickbait. Këto publikime kanë trajtuar tema të ndryshme, si dhënie të pasurisë, punësimin në Gjermani dhe Zvicër, infrastrukturën, shëndetin e fëmijëve etj.

Sa i përket temave të fushës politike, ato kanë trajtuar keqinformime për kryeministrin Kurti, ambasadorin e SHBA-së në Kosovë, pretendimet e pavërteta të mediave serbe për frikësimin e komunitetit serb nga institucionet kosovare, raportet Kosovë-Serbi, pretendime të pasakta nga mediat në gjuhën serbe e ruse sa i përket ndërhyrjes së NATO-s në ish-Jugosllavi etj. Shumica e artikujve me përmbajtje politike janë publikuar nga mediat reale dhe një pjesë tjetër nga mediat sociale, në gjuhën shqipe dhe në gjuhën serbe. Për më tepër, këto publikime kryesisht kanë marrë vlerësime clickbait, lajm i rremë dhe teori konspirative.




88% e përmbajtjeve keqinformuese janë për çështje sociale, politikën, kronikën e zezë, sigurinë dhe showbiz.

4

Llojet e publikuesve

Në krahasim me periudhat e mëhershme monitoruese, ky muaj karakterizohet nga fakti se mediat reale dhe faqe/grupe/profile të ndryshme në mediat sociale kanë publikuar më së shumti përmbajtje keqinformuese dhe atë në përqindje të njëjtë (45% secila prej këtyre dy llojeve të mediave) gjatë muajit mars 2023. Rrjedhimisht, 90% e publikimeve keqinformuese janë publikuar në mediat reale dhe mediat sociale, ndërsa vetëm 10% nga portalet e dyshimta.

DALLIMI NË PËRQINDJE NË MES
TË PUBLIKUESVE ME
PËRMBAJTJE KEQINFORMUESE




90% e artikujve me përmbajtje keqinformuese janë publikuar në mediat reale (45%) dhe mediat sociale (45%).

5

Klasifikimi i publikimeve të mediave në gjuhën shqipe dhe serbe

Kjo matje tregon se në cilën gjuhë janë publikuar artikujt keqinformues që janë monitoruar gjatë periudhës njëmuajore, duke i kategorizuar mediat në gjuhën shqipe, gjuhën serbe dhe publikimet në gjuhët tjera.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE TË MEDIAVE NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE



Në muajin mars 2023, mediat në gjuhën shqipe kanë publikuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese prej 81% lidhur me fusha e tema të ndryshme. Ndërkohë, 16% e artikujve keqinformues janë krijuar e shpërndarë nga mediat në gjuhën serbe. Kjo shënon rritje të dyfishtë në krahasim me muajin shkurt 2023 sa i përket publikimeve keqinformuese të këtyre mediave.

Analiza e artikujve të kësaj kategorie

5.1

Në këtë seksion të raportit analizohen publikimet keqinformuese të publikuara nga mediat në gjuhën shqipe, serbe dhe gjuhët tjera. Në vijim është përshkrimi i ndërlidhjes së tyre mes kategorizimeve, fushave dhe temave të trajtuara.

01. Publikimet e mediave në gjuhën shqipe

Shumica dërrmuese e publikimeve në gjuhën shqipe këtë muaj janë publikuar në mediat sociale dhe mediat reale, si dhe në numër dukshëm më të vogël nga portalet e dyshimta. Keqinformimet e krijuara në gjuhën shqipe kanë marrë më së shumti vlerësime clickbait, dezinformatë, mashtrim dhe lajm i rremë në fushën sociale, kronikën e zezë, showbiz, politikë dhe siguri.

02. Publikimet e mediave në gjuhën serbe

Të gjithë artikujt keqinformues të mediave në gjuhën serbe janë publikuar në fushën politike, sigurisë dhe sundimit të ligjit. Këto publikime janë në kontekst të zhvillimeve politike mes Kosovës e Serbisë, në pretendimet e pabaza dhe të rreme të mediave serbe ndaj komunitetit serb në Kosovë. Artikujt e mediave në gjuhën serbe janë vlerësuar si teori konspirative, dezinformatë, manipulim i fakteve, dhe përmbajtje e pa verifikuar.

03. Publikimet e mediave në gjuhët tjera


Matjet e të dhënave monitoruese tregojnë se dy prej artikujve keqinformues këtë muaj janë publikuar në gjuhë të tjera. Njëri prej tyre është në gjuhën ruse, i publikuar nga misioni rus i OSBE-së përmes faqes zyrtare në Twitter, duke shpërndarë një lajm të rremë për bombardimet e NATO-s në ish-Jugosllavi gjatë vitit 1999, si dhe një publikim tjetër, në gjuhën angleze, i cilësuar si mashtrim për Papa Françeskun, nga një llogari në Reddit.

Llojet e mediave sociale

Në këtë matje analizohen vetëm artikujt keqinformues të publikuar në mediat sociale dhe në këtë rast nuk përfshihen publikimet në mediat reale dhe portalet e dyshimta.

Ngjashëm si muajin e kaluar (shkurt 2023), edhe gjatë këtij muaji (mars 2023), faqe e media të ndryshme kanë publikuar më së shumti në Facebook prej 69% të publikimeve. Ajo pasohet nga TikTok me 25% dhe Twitter e Reddit me 3% secila prej tyre.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE




Llojet e publikuesve në mediat sociale

6.1

Ky seksion analizon përmes të dhënave monitoruese ndërveprimin në mediat sociale sa i përket publikimit dhe shpërndarjes së artikujve keqinformues nga publikues të ndryshëm të mediave sociale. Kjo bëhet përmes këtyre kategorive kryesore të publikuesve: faqeve, mediave, profileve, llogarive dhe faqeve zyrtare që menaxhohen nga përdorues të mediave sociale.

Siç vërehet, në muajin mars 2023, faqet, profilet dhe mediat (69% të tria së bashku) në Facebook kanë krijuar dhe shpërndarë më së shumti përmbajtje keqinformuese, e cila pasohet nga llogari dhe profile të ndryshme në TikTok prej 25%. Ndërsa, në Twitter (3%) dhe Reddit (3%) ka pasur më pak publikime të tilla në krahasim me Facebook dhe TikTok. Kjo matje tregon se këto dy të fundit shfrytëzohen më shumë në Kosovë se mediat tjera sociale.

PËRQINDJA E PUBLIKIMEVE NË MEDIAT SOCIALE



Analiza e llojeve të publikuesve në mediat sociale

Në vijim analizohen këto kategori të mediave sociale në ndërlidhje me publikimet dhe shpërndarjen e përmbajtjeve keqinformuese.

01. Facebook

Faqet - Faqet në Facebook kanë publikuar kryesisht artikuj për çështje sociale dhe motin, por edhe për politikën, sigurinë, kronikën e zezë dhe showbiz. Krahas kësaj, profilet në këtë media sociale kanë shpërndarë artikuj keqinformues vetëm për tema sociale.

Mediat - mediat kishin shpërndarë në Facebook vetëm një artikull në temën e sigurisë.

Të gjitha publikimet në Facebook janë në gjuhën shqipe që kanë marrë vlerësime të dezinformatës, mashtrimit, clickbait dhe përmbajtjes së pa verifikuar.

02. TikTok

Llogaritë në TikTok kanë krijuar dhe shpërndarë artikuj të ndryshëm keqinformues për showbiz, çështje sociale, politikë dhe siguri të kategorizuara si lajm i rremë, dezinformatë, mashtrim dhe teori konspirative. Ndërkaq, një llogari në TikTok ka publikuar një artikull me tematikë politike i vlerësuar si lajm i rremë. Të gjitha publikimet me përmbajtje keqinformuese në TikTok janë publikuar në gjuhën shqipe.

02. Reddit dhe Twitter


Reddit - Gjatë këtij muaji, vetëm një artikull keqinformues u publikua në Reddit nga një faqe në gjuhën angleze, i vlerësuar në kategorinë e mashtrimit.

Twitter - Edhe në Twitter, nga faqja zyrtare e misionit të Ruisë në OSBE u publikua një artikull keqinformues, i kategorizuar si lajm i rremë, në gjuhën ruse.

Figurat dhe institucionet më të përfolura

Kjo matje analizon të dhënat se cilat kanë qenë institucionet dhe personalitetet (figura publike e politike) më të përfolura përmes monitorimit të artikujve me përmbajtje keqinformuese.


RENDITJA E INSTITUCIONEVE MË TË PËRFOLURA SIPAS PËRQINDJES



Ngjashëm si me periudhën paraprake monitoruese, edhe gjatë muajit mars 2023, kishte më pak institucione të përfolura si pasojë e raportimit dhe mbulimit të temave të tjera nga mediat sociale, mediat reale dhe portalet e dyshimta që nuk kishin në fokus domosdoshmërisht institucione ose mekanizma të ndryshëm. Megjithatë, nga aktivitetet monitoruese shihet se institucioni më i përfolur është Policia e Kosovës nga mediat reale në gjuhën serbe, në pretendimet e tyre të rreme dhe të pavërteta se qytetarë serbë në Kosovë janë arrestuar për motive etnike ose se ata janë rrahur nga Policia e Kosovës. Këto lajme në fushën e sigurisë janë vlerësuar si dezinformata dhe manipulim i fakteve.

Edhe NATO është përfolur nga mediat serbe në një raportim të pa verifikuar se, gjatë fushatës ajrore kundër caqeve të ushtrisë jugosllave/serbe më 1999, ishin hedhur 37.000 bomba thërrmuese, pa u bazuar në ndonjë fakt.

RENDITJA E PERSONAVE MË TË PËRFOLUR SIPAS PËRQINDJES



Sa i përket figurave, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, edhe këtë muaj, është më i përfoluri kryesisht për çështje politike dhe të sigurisë nga media në gjuhën shqipe dhe serbe. Llogari dhe faqe në Facebook e TikTok, si dhe media reale në gjuhën shqipe kanë krijuar dhe shpërndarë keqinformime me pretendime të rreme se grupi “Wagner” ka ofruar para për vrasjen e Kurtit. Ndërsa, mediat reale në gjuhën serbe pretendojnë pa fakte se institucionet e shtetit të Kosovës po shfrytëzojnë religjionin islam për të ushtruar presion ndaj serbëve të Kosovës dhe pretendime të politikanëve të Serbisë se qëllimi i Kurtit është dëbimi i serbëve nga Kosova. Publikimet e mediave në gjuhën serbe ndaj Kurtit janë vlerësuar si teori konspirative.

Personalitete të tjera të përfolura janë Luiz Ejlli nga programi “Big Brother Vip Albania”, ambasadori i SHBA-së në Kosovë, Jeffrey M. Hovenier, ish-kryeministri britanik, Boris Johnson etj.

Metodologjia

Për hartimin e këtij raporti monitorues janë përdorur metodat kuantitative dhe ato kualitative.

Sa i përket metodave kuantitative, fillimisht është krijuar baza e të dhënave nga ADS/hibrid.info me qëllim të zbërthimit dhe analizimit të detajuar të trendëve të keqinformimit. Përmes kësaj baze të të dhënave, e cila mirëmbahet dhe përditësohet në bazë të rregullta ditore nga stafi i ADS/hibrid.info, monitorohen rregullisht artikujt me përmbajtje keqinformuese.

Kjo nënkupton se të gjitha artikujt e publikuar në platformën hibrid.info vendosen në bazën e të dhënave dhe kjo e fundit shërben ndër burimet kryesore për përgatitjen e raportit monitorues. Për më tepër, metodologjia e përdorur për analizimin e të dhënave të paraqitura në raportin monitorues bën të mundur filtrimin e të dhënave në baza ditore, javore e mujore dhe atë në formë kryesisht kuantitative për të kuptuar më qartë fenomenin e keqinformimit të atyre artikujve të analizuar për këtë periudhë monitoruese njëmuajore sipas kategorive e vlerësimeve të ndryshme.

Krahas kësaj, një burim tjetër i rëndësishëm për këtë raport është metodologjia e ADS/hibrid.info (e publikuar në faqen e hibrid.info) për luftën kundër dezinformatës dhe lajmeve të rreme. Metodologjia, e cila është e bazuar para së gjithash në metodat kualitative, është hartuar nga stafi profesional i ADS/hibrid.info dhe është në harmoni me standardet më të larta ndërkombëtare për kontroll të fakteve, gjegjësisht sipas udhëzimeve të Rrjetit Ndërkombëtar për Kontroll të Fakteve (IFCN). ADS/hibrid.info është anëtarë me të drejta të plota në këtë mekanizëm ndërkombëtar – IFCN.

Ky raport monitorues përfshin periudhën nga 1 deri më 31 mars 2023.

Ky raport i shkurtër monitorues paraqet një pasqyrë të gjendjes njëmuajore të informimit (keqinformimit) gjatë muajit mars 2023, nga të dhënat e platformës për kontroll të fakteve – hibrid.info.

Të dhënat e monitorimit për këtë periudhë njëmuajore tregojnë se mediat reale, mediat sociale dhe portalet e dyshimta kanë shpërndarë më së shumti keqinformime për dhe rreth Kosovës në kategorinë clickbait me 27%, dezinformatë me 26% dhe mashtrim 14%. Vlerësime “Clickbait” kryesisht kanë marrë keqinformimet për kronikën e zezë dhe çështjet sociale, si vrasje, zhdukje, protesta, shëndeti i fëmijëve, punësimi në Gjermani, punëtorët etj. Artikujt keqinformues të kategorizuar si “Dezinformatë” i përkasin fushës sociale në të cilat trajtohen punësimi në Gjermani dhe Zvicër, diaspora në Zvicër, transporti rrugor, programi “Big Brother Vip Albania” dhe çështje të sigurisë lidhur me veriun e Kosovës, derisa nuk kishte publikime keqinformuese në fushën politike. Edhe në kategorinë vlerësuese “Mashtrim” kanë mbizotëruar temat sociale.

Gjatë këtij muaji (mars 2023), temat kryesore mbi të cilat mediat kanë krijuar dhe shpërndarë publikime keqinformuese janë për dhënie të pasurisë, programin “Big Brother Vip Albania”, punësimin në Gjermani, kryeministrin Kurti, vrasje, pretendime të pabaza se serbët janë nën presion të institucioneve të Kosovës dhe tema tjera. Edhe ky muaj, sikurse muaji paraprak (shkurt 2023), karakterizohet nga shpeshtësia e temave sociale, ndërsa kishte dukshëm më pak për veriun e Kosovës dhe dialogun Kosovë-Serbi, ndonëse temat politike janë në vendin e dytë menjëherë pas çështjeve sociale. Pothuajse të gjitha keqinformimet për çështje sociale janë publikuar në gjuhën shqipe, kryesisht nga mediat sociale dhe më pak nga mediat reale dhe portalet e dyshimta, ndërsa artikujt me përmbajtje politike janë publikuar nga mediat në gjuhën serbe dhe në gjuhën shqipe. Vlen të përmendet se fushat kryesore të keqinformimit janë çështjet sociale me 36%, politika shumë më pak me 16% dhe kronika e zezë me 14%.

Mediat reale me 45% dhe mediat sociale me 45%, po ashtu, kanë publikuar numrin më të madh të përmbajtjeve keqinformuese për këtë periudhë një mujore monitoruese prej 90% gjithsej, ndërsa portalet e dyshimta kanë publikuar 10% të këtyre përmbajtjeve. Prej mediave reale, shumica dërrmuese e tyre janë në gjuhën shqipe për kronikë të zezë dhe çështje sociale më së shumti, si dhe dukshëm më pak artikuj keqinformues për politikë. Ndërsa, mediat reale në gjuhën serbe kanë krijuar dhe shpërndarë artikuj vetëm për çështje politike, të sigurisë dhe sundimit të ligjit lidhur me zhvillimet në Kosovë. Sa i përket mediave sociale, në Facebook janë shpërndarë më së shumti keqinformime prej 69%, e cila pasohet nga TikTok me 25%, si dhe Twitter e Reddit me 3% secila prej tyre. Pothuajse të gjitha publikimet në media sociale janë në gjuhën shqipe, në të cilat mbizotërojnë keqinformimet për temat sociale, pasuar nga showbiz, politika, siguria dhe moti. Sipas monitorimit, 81% e publikimeve janë publikuar nga mediat në gjuhën shqipe, 16% nga ato në gjuhën serbe dhe 2% nga media në gjuhë të tjera (anglisht dhe rusisht).

Institucioni më i përfolur, gjatë muajit mars 2023, është Policia e Kosovës nga mediat në gjuhën serbe, në pretendimet e tyre të pavërteta se qytetarët serbë në Kosovë janë nën presion dhe kërcënim të Policisë së Kosovës. Prej personaliteteve, edhe këtë muaj, kryeministri Albin Kurti është më i përfoluri për çështje politike dhe të sigurisë nga mediat në gjuhën shqipe dhe serbe.

HIBRIDO.INFO